

## STATUT I SHOQËRISË

### “PORTO ROMANO REFINERY” SHA

Shoqëria “PORTO ROMANO REFINERY” SHA themelohet në datën e nënshkrimit nga aksionari i vetëm i mëposhtëm:

1. QALA CAPITAL HOLDINGS SHPK, një shoqëri e themeluar në mënyrë të rregullt dhe që vepron sipas ligjeve të shtetit Shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit L915210070 me seli në Bulevardi Zogu I, Pallati Rreli-98, Kati 2, Zyra 1, 1016, Tirane (“Aksionari i Vetëm”), përfaqësuar nga Z. Enis Aliko, autorizuar në bazë të Prokurës së Posaçme Nr 1323 Rep, Nr. 243 Kol, datë 21.03.2019.

## KAPITULLI I

### KRIJIMI; FORMA; SELIA EMRI; KOHËZGJATJA; OBJEKTI

#### Neni 1 – Aksionarët

- 1.1 Aksionari i vetëm i Shoqërisë është:

#### QALA CAPITAL HOLDINGS SHPK

#### Neni 2 – Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria është në formën e shoqërisë aksionare dhe është e organizuar dhe funksionon në përputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët Shoqërítë Tregtare” (“Ligji Tregtar”).

#### Neni 3 – Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Bulevardi Zogu I, Pallati Rreli-98, Kati 2, Zyra 1, 1016, Tiranë, Shqipëri.

- 3.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e Shqipërisë me vendim të Aksionarit të vetëm.

#### Neni 4 – Emri

- 4.1 Emri i shoqërisë është “PORTO ROMANO REFINERY” SHA.



## Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

## Neni 6 – Objekti

6.1 Objekti kryesor i veprimitarise së shoqërisë do të jetë:

- Projektimi, ndërtimi dhe përdorimi i impianteve teknologjike p.sh rafinerive, tubacioneve dhe depozitave, për përpunimin e naftës bruto dhe gazit, transportin, magazinimin dhe tregimin, importin dhe eksportin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe biokarburanteve; tregtia, importi dhe eksporti i mallrave industrial, materialeve të ndërtimit, pajisjeve për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e impianteve teknologjike (rafinerive), tubacionet, tanket dhe depozitat për gaz, naftë dhe nënproduktet e tyre, dhe biokarburantet.
- Prodhimi, përpunimi dhe tregimi (importi dhe eksporti) i naftës dhe nënprodukteve të saj; blerja, importimi, eksportimi, transportimi, gjithashtu në emër të palëve të treta, shitja me shumicë e gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe petrokimikëve duke përfshirë bitumin. Projektimi, ndërtimi dhe përdorimi i impianteve teknologjike për prodhimin e energjisë dhe ujit të nxehëtë dhe shitja e tyre në tregun e brendshëm dhe ndërkontinentar.
- Ndërtimi, përdorimi dhe transferimi i termocentraleve të shkarkimit të naftës/ gazit, duke përfshirë financimin, projektimin, ndërtimin, dhe komisionet.
- Ndërtimi dhe përdorimi i linjave të gazit dhe infrastrukturës së tyre plotësuese si stacionet matëse dhe valvulat e presionit.
- Ndërtimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike si dhe infrastrukturës funksionale siç janë stacionet e energjisë dhe nënstacionet.
- Blerja, ndërtimi, administrimi, shitja dhe marrja me qira e impianteve, depozitave dhe administrimi i ndërtesave dhe pasurive të paluajtshme.
- Ndërtimi dhe funksionimi i linjave të furnizimit me ujë, kryerja e aktivitetave në sektorin e ujësjellësit përmes transferimit, shpërndarjes dhe tregimit të ujit teknologjik.

6.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me Vendim të Aksionarit të Vetëm.

6.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimitari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

6.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjera fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimitari në Shqipëri ose jashtë saj.

## KAPITULLI II

### KAPITALI; AKSIONET

#### Neni 7 – Kontributet

- 7.1 Kapitali i shoqërisë në momentin e themelimit është në shumën 3.500.000 LEK (tre milion e pesëqind mijë lekë). 25% e kapitalit të regjistruar në vlerën prej 875.000 lekë (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) është paguar në një llogari bankare të Intesa Sanpaolo Bank, Tiranë, Shqipëri. Pjesa e mbetur e kapitalit të nënshkruar paguhet nga Aksionari i vetëm me kërkesë të Administratorit të Shoqërisë, por në çdo rast, jo më vonë se 1 (një) vit nga data e këtij Statutit.
- 7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1000 aksione me vlerë nominale prej 3.500 LEK (tre mijë e pesëqind lekë) secili.
- 7.3. Aksionari i vetëm zoteron pjesën e mëposhtme në kapitalin e Shoqërisë:

1. "QALA CAPITAL HOLDINGS SHPK zoteron 100 % të aksioneve, 1000 aksione që i korrespondojnë vlerës totale prej 3.500.000 LEK (tre milion e pesëqind mijë lekë).

#### **Neni 8 – Zmadhimi i Kapitalit**

- 8.1 Kapitali mund të zmadhohet me vendim të Aksionarit të vetëm, mbi bazën e një raporti të paraqitur para tij nga Këshilli i Administrimit.
- 8.2 Aksionari i vetëm, do të përcaktojë datat në të cilat do të paguhen kontributet për rritjen e kapitalit ose do t'i delegojë Këshillit të Administrimit detyrën për të përcaktuar mënyrën, kohën dhe metodat e pagimit të këtij kontributi.
- 8.3 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë ushtrohet në proporcione me aksionet e zotuar nga secili aksionar përparrë zmadhimit të kapitalit. Aksionarët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja.
- 8.4 Në rastin e zmadhimit të kapitalit me kontribute në natyrë, me vendim gjykatë caktohet një ekspert për vlerësuar kontributet në natyrë ne përputhje me Ligjin Tregtar.

#### **Neni 9 – Zvogëlimi i Kapitalit**

- 9.1 Zvogëlimi kapitalit realizohet me vendim të Aksionarit të vetëm për çfarë do lloj arsyё ose mënyre, por në çdo rast zvogëlimi i prek aksionarët ne mënyrë proporcionale.
- 9.2 Këshilli i Administrimit duhet t'i dorëzojë një raport të arsyetuar për zvogëlimin e kapitalit, Aksionarit të vetëm për të marrë vendim në lidhje më të, duke përshkruar rrethanat që kanë bërë të detyrueshme zvogëlimin e kapitalit.

#### **Neni 10 – Shlyerja dhe Verifikimi i Kapitalit**

- 10.1 Shoqëria nuk mund të emetojë aksione të reja për zmadhimin e kapitalit në qoftë se kapitali themeltar i shoqërisë nuk është shlyer plotësisht.



- 10.2 Në qoftë se aksionarët nuk shlyejnë kontributin që është bërë i pagueshëm dhe i detyrueshëm sipas nenit 8.2 më sipër, zbatohet neni 124 i Ligjit Tregtar.

#### **Neni 11 – Aksionet; Regjistri i Aksioneve**

- 11.1 Aksionet janë nominale dhe do të regjistrohen në një regjistër të veçantë i cili duhet të përbajë emrin e aksionarit, vlerën nominale të aksioneve, numrin e aksioneve të zotëruara nga secili aksionar, adresën e aksionarëve, datën në të cilën aksionet i janë transferuar çdo aksionari. Administratori i Shoqërisë është personi përgjegjës mbajtjen e regjistrat të veçantë të aksioneve.
- 11.2 Aksionet janë të pandashme. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.
- 11.3 Zotëruesi i ligjshëm i ushtron të drejtat dhe detyrimet e aksioneve. Zotëruesi i ligjshëm i aksioneve prezumohet se është personi i regjistruar në regjistrin e veçantë të aksioneve.

#### **Neni 12 – Transferimi i Aksioneve**

- 12.1 Aksionari i vetëm është pronari ekskluziv i të gjitha aksioneve të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- 12.2 Aksionet e kapitalit të regjistruar mund ti transferohen palëve të treta, të gjitha ose veçmas, vetëm me shkrim.
- 12.3 Aksionet e kapitalit të regjistruar transferohen pa ndonjë akt të shkruar në veçanti.

#### **Neni 13 – Të drejtat dhe detyrimet që lidhen me aksionet**

- 13.1 Çdo aksion i jep të drejtën zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë në raport më aksionet që ai/ajo përfaqëson dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në aktivet e mbeturat të shoqërisë.
- 13.2 Aksionarët janë përgjegjës deri në vlerën nominale të aksioneve të tyre.
- 13.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aksionet ndjekin aksionet pavarësisht nga transferimi i tyre.

### **KAPITULLI III**

#### **ORGANET KOMPETENTE**

#### **Neni 14 – Aksionari i vetëm**

- 14.1 Vendimet kryesore të veprimitarisë së shoqërisë merren me nënshkrimin e Aksionarit të vetëm i cili është organi më i lartë i Shoqërisë me të drejtën për të miratuar vendime lidhur me çështjet e ushtrimit të aktivitetit të saj në përputhje me Ligjin për Tregtarët dhe këtë Statut. Miratimi i vendimit nga Aksionari i vetëm duhet të regjistrohet në një regjistër të vendimeve të marra, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen. Për sa kohë që shoqëria ka një Aksionar të



vetëm, miratimi i vendimeve të marra do të jetë në formën e një dokumenti të vetëm të nënshkruar nga Aksionari i vetëm dhe nuk do të mbahet procesverbal.

- 14.2 Vetëm Aksionari i vetëm ka të drejtë të ndryshojë Statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo kufizim tjetër është i pavlefshëm.
- 14.3 Të drejtat dhe detyrimet e Aksionarit të vetëm të shoqërisë ekzekutohen drejtpërdrejtë nga përfaqësuesi i caktuar nga organi i autorizuar i Aksionarit të vetëm.
- 14.4 Vetëm Aksionari i vetëm ka të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme, duke përfshirë por pa u kufizuar në :
- (i) Miratimi ose jo i bilancit finansiar vjetor të Shoqërisë;
  - (ii) Miratimi i programit ekonomik finansiar të Shoqërisë për vitin pasardhës;
  - (iii) Emërimi, zëvendësimi, pezullimi apo pushimi i Ekspertëve Kontabël të Shoqërisë si dhe të vendosë për shpérblimin e tyre;
  - (iv) Autorizon lëshimin e letrave me vlerë dhe çështjet e akteve të veçanta të sigurisë të lidhura me to;
  - (v) Destinacioni i fitimit neto të Shoqërisë;
  - (vi) Pagesa e organeve të Shoqërisë;
  - (vii) Masa e dividentit që do të shpërndahet;
  - (viii) Prishja e Shoqërisë;
  - (ix) Emërimi, zëvendësimi, pezullimi apo pushimi i anëtarëve të Këshillit te Administrimit të Shoqërisë, si dhe caktimi i shpérblimit të tyre;
  - (x) Tjetërsimi i aksioneve të shoqërisë;
  - (xi) Emetimi apo ndarja e aksioneve të reja ose tituve duke rritur, zvogëluar apo në çdo rast duke modifikuar kapitalin e Shoqërisë ose gjithsesi duke ndryshuar strukturën e kapitalit të Shoqërisë;
  - (xii) Ndryshimin e politikës së shpérndarjes së dividentit të Shoqërisë;
  - (xiii) Të hyjë në marrëveshje për të blerë, shitur ose hipotekuar të drejta, tituj apo interesa në të gjitha apo në një pjesë materiale të aktivit apo apo pasurisë së Shoqërisë, përvèç atyre gjatë kursit normal të biznesit;
  - (xiv) Dhënia e huave ose garancive ose sigurimi për çdo detyrim të palëve të treta;
  - (xv) Ndryshim thelbësor i veprimtarisë ose drejtimit të Shoqërisë;
  - (xvi) Transferimi i patentave, markave, të drejtave të autorit dhe çdo pronësie intelektuale të Shoqërisë ose të zotëruara nga Shoqëria ne baze të licencave përkatëse;
  - (xvii) Blerja e tokave ose ambiente ose pasuritë e paluajtshme;
  - (xviii) Ndryshimi i strukturës ligjore të Shoqërisë;
  - (xix) Çdo veprim për të cilin ky nen apo Ligji Tregtar ia njeh atij ekskluzivisht.



## **Neni 15 – E Drejta e Informimit**

- 15.1 Administratori i Shoqërisë është i detyruar të vërë në dispozicion të Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë në çdo kohë të gjitha dokumentet që parashikohen në nenin 15 të Ligjit Tregtar.

## **Neni 16 – Këshilli i Administrimit**

- 16.1 Shoqëria do të administrohet nga Këshilli i Administrimit i cili është i organi i vetëm administrativ i Shoqërisë dhe ushtron funksionet e administrimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së Shoqërisë (sistemi me një nivel).
- 16.2 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) antarë të emëruar për një afat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje, secili me eksperiencën dhe kualifikimin e nevojshëm për të drejtuar dhe mbikëqyrur administrimin e Shoqërisë. Drejtori i Përgjithshëm/Administratori mund të jetë gjithashtu një anëtar i Këshillit i Administrimit.
- 16.3 Përjashtimisht, Kryetari i parë i Këshillit të Administrimi do të zgjidhet dhe emërohet në mesin e anëtarëve të Këshillit sipas këtij Statuti dhe emërimi i tij do të ratifikohet përkatësisht ne mbledhjen e parë të anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit do të janë si më poshtë:
- **Luis Felipe Rosas Salazar (Kryetar)**, lindur më 19.09.1974, në Caracas Ven, mbajtës i pasaportës nr. 115630077 dhe me nr. personal 10002768;
  - **Jayme De Oliveira Santos Neto**, lindur më 06.04.1979, në Rio De Janeiro, mbajtës i pasaportës nr. FU944322;
  - **Enis Aliko**, lindur më 28.05.1962, në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. personal G20528051W.
- 16.4 Përveç Kryetarit të parë të Këshillit dhe Administratorit të parë të Shoqërisë të cilët janë emëruar sipas nenit të mësipërm 16.3 dhe nenit 19.4 të mëposhtëm të këtij Statuti dhe qe do të ratifikohet në mbledhjen e parë të Këshillit të Administrimit, Kryetaret dhe Administratoret e rradhës te Shoqërisë qe do te zgjidhen herë pas herë do të zgjidhen dhe emërohen nga Këshilli i Administrimit.
- 16.5 Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë marrin pjesë në mbledhjet përkatëse dhe duhet përbushin menjëherë çdo vendim të miratuar herë pas here nga Aksionari i vetëm i Shoqërisë /ose Këshillit të Administrimit.

## **Neni 17 – Kompetencat e Këshillit të Administrimit**


- 17.1 Këshilli i Administrimit ka kompetenca ekskluzive për çështje që nuk i përkasin Administratorit të Shoqërisë dhe në veçanti ato që i përkasin zbatimin e politikave dhe strategjive tregtare të përcaktuar nga mbledhja e aksionarëve të Shoqërisë dhe nenit 154 të Ligjit Tregtar.



## Neni 18 – Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- 18.1 Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen ne kohën e përcaktuar nga Kryetari i Këshillit të Administrimit. Këshilli i Administrimit do të mblidhet të paktën një herë në vit. Vendimet e Këshillit do të merren nëpërmjet nënshkrimit të procesverbalit përkatës.
- 18.2 Vendimet e Këshillit të Administrimit do të miratohen në mënyrë të vlefshme me shumicën e votave të anëtarëve. Në rast numri të barabartë votash, vendimi i Këshillit i takon Kryetarit i cili në këtë rast ka të drejtën e votës vendimmarrëse.
- 18.3 Këshilli i Administrimit merr vendime dhe nëpërmjet tele-konferencave ose video konferencave ose mjeteve të tjera të komunikimit të njëkohësishtëm në distancë. Një vendim mund të merret vetëm nëse të gjithë anëtarët janë informuar në kohë mbi përbajtjen e vendimit. Vendimi do të merret në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 18.2 të lartpërmendor.
- 18.4 Këshillit të Administrimit mund të marrë vendime edhe me një vendim qarkullues të hartuar dhe propozuar nga cilido anëtar i Këshillit, pa thirrur mbledhjen, me kusht që të gjithë anëtarët ta miratojnë këtë vendim.

## Neni 19 – Administratori i Shoqërisë

- 19.1 Administratori i Shoqërisë emërohet nga Këshilli i Administrimit për një periudhë maksimale tre vjeçare, me te drejtë rizgjedhje dhe është përfaqësuesi ligor i Shoqërisë.
- 19.2 Në vijim të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuar në nenin 158 të Ligjit Tregtar, do të ketë kompetencat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:
  - (i) do të jetë përgjegjës për administrimin e përditshëm të veprimtarisë tregtare dhe, në veçanti mbikëqyrjen e çështjeve administrative dhe organizative të Shoqërisë në përputhje me politikat dhe strategjitet tregtare të përcaktuara nga Këshilli i Administrimit.
  - (ii) i paraqet çdo tre muaj Kryetari të Këshillit të Administrimit një raport i cili paraqet të gjitha faktet dhe rr Ethanat e rëndësishme, rezultatin financiar për këtë periudhë si dhe parashikimin për tremujorin e ardhshëm; dhe
  - (iii) do të ketë në çdo rast detyrat dhe kompetencat e deleguara nga Këshilli i Administrimit, i cili gjithmonë do të ketë kompetenca të njëkohshme.
- 19.3 Administratori i Shoqërisë do të kryejë funksionet e tij në përputhje me kufizimet te vendosura me vendim të Këshillit të Administrimit.
- 19.4 Administratori i parë i Shoqërisë i emëruar në bazë të këtij Statuti është: Z.Alban Çaushi, lindur në Tiranë, më 25.03.1973, me nr personal letërnjoftimi H30325175J, për një afat maksimal prej 3 muajsh.  




## KAPITULLI IV

### KONTROLLI I SHOQËRISË

#### Neni 20 – Auditori

20.1 Aksionari i vetëm emëron auditor për çdo vit finansiar me kompetencat, por jo vetëm, të mëposhtme:

- Ndihmë në mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit;
- Përgatitja e raporteve vjetore me të dhëna ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe dhënia e mendimeve nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë.
- Informon Këshillin e Administrimit mbi çdo parregullsi të mundshme të vënë re në procedura, aktivet e shoqërisë që mund të kenë shkaktuar humbje për shoqërinë.

20.2 Auditori i parë i Shoqërisë është Mazars shpk, nr i licenses 110 datë 06.11.2006.

#### Neni 21 – Librat e Shoqërisë

21.1 Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilët regjistrohen llogaritë vjetore, pasqyrat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore të cilët duhet të përbajnë çdo gjë që parashikohet nga ligji.

21.2 Librat e shoqërisë si dhe pasqyrat financiare, bilancet vjetore dhe raportet financiare vjetore mbahen në gjuhën Shqipe dhe në monedhën Lek.

#### Neni 22 – Viti Financiar

22.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor.


#### Neni 23 – Rezerva e Domosdoshme Ligjore

23.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 për qind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humbjeve të viteve të kaluara. Një procedurë e tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 1/10 e kapitalit aksionar.

## KAPITULLI V

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 24 – Shpërndarja, Ligji i Zbatueshëm, Gjuha



- 24.1 Shoqëria shpërndahet dhe do të likuidohet në përputhje me Ligjin Tregtar dhe ligje të tjera të zbatueshme.
- 24.2 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.
- 24.3 Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjes midis dy versioneve, versioni në anglisht do të mbizotërojë.

Nënshkruar në Tiranë, Shqipëri më 30 Gusht 2019 nga :

**AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISË**

QALA CAPITAL HOLDINGS SHPK

*Përfaqësuar nga:*

